

Shpatull-Astar 2-K

UZIN PE 630



Astar mbushës çimento-disperzive

Fushëveprimet:

Astar brumor, 2-K çimento-disperzive shumë i shpejtë për nënshtresa në renovim para të gjitha punimeve me shpatull me masa rrafshuese në bazë çimentoje apo kalciumsulfati, brenda.

Përshtatshëm për/mbi:

- ▶ Lyerje me astar nënshtresave të vjetra kritike para punimeve me shpatull
- ▶ Dysheme druri natyral apo i gërryer, Kompensatë V 100, Pllaka-OSB, Parket apo nënshtresa tjera druri me pjesë fugash
- ▶ Nënshtresa me mbeturina të ngjitësit apo masave rrafshuese, të lidhura mirë, ujërezistente si dhe bituminoze
- ▶ Estrih i pazalluar asfalti rrjedhës
- ▶ Lyerje (shtresa) të gërryera mat
- ▶ Nënshtresa të lëmuara dhe të ngjeshura apo dysheme të vjetra si p.sh. mbi pllaka të ngjitura mirë nga qeramika ose guri natyror, Terrazzo
- ▶ Estrih magnezi dhe estrih gur-dru, UZIN Multimoll Top 9/ Top 15 Pllaka
- ▶ Ngarkesë e lartë në ambiente banimi, afariste dhe industriale
- ▶ Ngrohje e dyshemesë me ujë të ngrohtë
- ▶ Ngarkesë me rrota karrigash sipas DIN EN 12 529
- ▶ Si komponentë sistemi në ndërtim të shpejtë




së lartë si dhe lidhjes së shkëlqyeshme me nënshtresën dhe masat rrafshuese minerale. Lidhet në mënyrë hidraulike, mbush, mbyll dhe lëmon nënshtresat, thahet „fortë-elastik“ andaj absorbon shumë mirë lëvizjet në nënshtresë.

Materiali lidhës: Stirol-Kopolimer i modifikuar, çimento speciale, aditivë dhe shtojca minerale.

- ▶ Mbush, mbyll dhe rrafshon në një punëveprim
- ▶ Në shtresëtrashësi deri 1mm
- ▶ Lidhje hidraulike
- ▶ Pas tharjes, fleksibil dhe i deformueshëm
- ▶ GISCODE ZP 1 / kromat-varfër (Komponenti pluhur)
- ▶ GISCODE D 1 / Pa tretës (Komponenti disperziv)
- ▶ EMICODE EC1R / Shumë i varfër në emisione

Përparësitë e produktit/Vetitë:

Dispersion polimeri me komponentin pluhur ujëlidhës, pas përzierjes krijon një astar brumor mbushës të mirë me veti shumë të mira përpunimi dhe përdorimi. UZIN PE 630 na bind përmes shpejtësisë së jashtëzakonshme, deformueshmërisë (fleksibilitetit)



Shenimet teknike:

Lloji i paketimit:	Kovë-plastike, përmban kantë plastike dhe thes letre
Sasia e paketimit:	16 kg Njësia e kombinuar
Qëndrueshmëria:	së paku 6 muaj
Ngjyra (A+B), lëngët/ thatë:	hiri hapur/ hiri mbylltë
Raporti i përzierjes:	A : B = 3 : 5 Njësi peshe
Koha e punës:	50 - 60 Minuta *
Konsumi:	100 - 600 g/m ²
Temperatura e punës:	së paku 15°C mbi dysheme
Koha e tharjes, i rrafshueshëm pas:	40 - 120 Minuta*

*Në temperaturë 20°C dhe 65% lagështi relative të ajrit, në shtresëtrashësi maksimale prej 1 mm. Shih edhe „Tabela aplikative“

Përgatitja e nënshtresës:

Nënshtresa duhet të jetë e thatë, e fortë, e pastër, pa çarje dhe substanca të cilat mund të ndikojnë negativisht në ngjitje. Të gjitha parregullsitë në nënshtresë duhet të sanohen. Kontrolloni nënshtresën në bazë të normave dhe fletushkave dhe në rast të mangësive lajmëroni shqetësimet tuaja tek klienti.

Shtresat që dobësojnë lidhjen dhe ato labile, p.sh. shtresa ndarëse, mbeturinat e shkoqitura të ngjitësit, masës rrafshuese, dyshemesë, llakut, materialit përkujdesës apo të llyerjeve të ndryshme etj. hiqen p.sh. përmes pastrimit me brusha, gërryerjes apo frezimit. Pjesët labile dhe pluhuri duhet thithur rrënjësisht. Të gjitha mbeturinat e lidhura duhet të testohen në rezistencën ndaj ujit. Nëse nuk janë rezistent ndaj ujit, (Testi i ujit: shtrati i ngjitësit pas një ndikimi të shkurtër të ujit tretet) përdorni Astarin 2K pa ujë dhe pa tretës UZIN PE 460. Astari duhet gjithmonë të thahet plotësisht. Respektoni të dhënat teknike të produkteve të bashkëpërdorura.

Punimi:

1. Paketimi origjinal 16 kilogramësh është i projektuar si kovë për përzierje. Komponentin disperziv dhe atë pluhur nxirreni nga paketimi origjinal. Komponentin disperziv A zbrazeni në paketimin origjinal (kovën 16kg), komponentin pluhur B nën përzierje të fortë derdheni ngadalë dhe përzierje në një masë homogjene dhe pa kokrra. Disa minuta të përziehet rrënjësisht me një përzierëse spirale. Të përgatitet vetëm aq astar sa mund të punohet brenda 60 minutash.
2. UZIN PE 630 të shtrihet hollë me një rrafshues.
3. Për t'a lehtësuar mbushjen e nënshtresave me përmbajtje të madhe fugash, çdo 16 kg kove mund t'i shtohet deri në 10 kg UZIN NC 182 për përzierje.

Tabela aplikative:

Astari të lihet të thahet, deri sa të jetë i shkëlqshëm dhe ngjyra nga hiri i hapur të bëhet hiri i mbylltë.

Në rast se pason rrafshimi me masë rrafshuese në bazë kalciumsulfati (gipsi) duhet t'u përmbahemi kohëtharjes prej 12 orësh.

Nënshtresa	Konsumi	Kohëtharja
Kompensatë druri, nënshtresa druri, parket të vjetër, UZIN Multimoll	100 - 300 g/m ²	40 - 60 minuta*
Ngjitëset rezistente ndaj ujit, me lidhje të mirë.	100 - 300 g/m ²	40 - 60 minuta*
Estrih i pazalluar nga asfalti rrjedhës, shtresë-lyerje, gur natyror, qeramikë, teraco, estrih magnezi dhe estrih gurdru.	100 - 300 g/m ²	90 - 120 minuta*
Nënshtresa me shumë fuga (shtesa e UZIN NC 182 e mundshme)	300 - 600 g/m ²	90 - 120 minuta*

*Në temperaturë 20°C dhe 65% lagështi relative të ajrit, në shtresëtrashësi maksimale prej 1 mm me astar pa përzierje.

Udhëzime të rëndësishme:

- ▶ Paketimi origjinal në vend të freskët mund të qëndrojë së paku 6 muaj. Të ruhet nga ngricat. Paketimin e hapur mbylleni mirë dhe përmbajtjen përdoreni sa më shpejtë.
- ▶ Përpunimi më i mirë në 15 - 25 °C, temperatura e dyshemesë mbi 15 °C dhe lagështia relative e ajrit nën 75%. Temperatura e ulët dhe lagështia e lartë e ajrit zgjasin ndërsa temperatura e lartë dhe lagështia e ulët shkurtojnë kohën e tharjes.
- ▶ Tek nënshtresat me shumë fuga çdo paketimi 16 kg mund t'i shtohen maksimalisht deri 10 kg UZIN NC 182
- ▶ Jo për ambiente të jashtme dhe të lagështa.
- ▶ Tek nivelizimet mbi 10 mm shtresëtrashësi preferohen Astarët me rrëshirë epoksidi, si UZIN PE 460 i mbuluar me rërë ose të kërkohej këshilla tekniko-aplikative.
- ▶ Në rast mbulimi me masë rrafshuese në bazë kalcium-sulfati (gipsi) duhet një kohë më e gjatë e tharjes së astarit. Shih udhëzimin „Tabela aplikative“.
- ▶ Nuk është i përshtatshëm mbi mbeturina të ngjitësve të tretshëm me ujë (p.sh. Ngjitës tretësire sulfiti) apo fiksuesve. Këtu përdorni UZIN PE 460 të mbuluar me rërë.
- ▶ UZIN PE 630 i përzier me UZIN NC 182 mbi nënshtresa të përshtshme mund të përdoret për ngjitje direkte të dyshemeve tekstile.
- ▶ Të vlefshme gjegj. për vëmendje të veçantë rekomandohen ndër tjerash Normat dhe fletushkat në vijim:
 - DIN 18 365 „Punime të dyshemesë“
 - DIN 18 356 „Punime të parketit dhe kubëzave druri“
 - DIN 18 352 „Shtruarja e pllakave dhe gurit natyral“
 - TKB-Fletushka „Vlerësimi dhe përgatitja e nënshtresës për punime të dyshemesë dhe parketit“
 - BEB-Fletushka „Vlerësimi dhe përgatitja e nënshtresave“

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e ambientit:

Komponenti dispersiv A:

GISCODE D 1 – Pa tretës në bazë të TRGS 610. Jo i ndezshëm. Gjatë përpunimit rekomandohet parimisht përdorimi i kemit mbrojtës për lëkurë si dhe ajrosja e ambientit të punës

Komponenti pluhur B:

Përmban çimento, i varfër në kromate sipas RL 2003/53/EG - GISCODE ZP 1. Çimentoja në kontakt me ujin reagon shumë alkaline, andaj të shmangët kontakti me lëkurë dhe me sy, në rast të kontaktit menjëherë të shpërlahet me ujë. Në rast iritimi të lëkurës apo syve të vizitohet mjeku. Përdorni dorëza mbrojtëse. Gjatë përzierjes përdorni maska kundër pluhurit. Në gjendje të ngurtësuar, të tharë fiziolgjikisht dhe ekologjikisht i padëmshëm.

Kushtet themelore për ajër më të mirë të ambientit pas punimeve të dyshemesë janë kushtet normative për instalim të dyshemesë dhe tharja e plotë e nënshtresave, astarëve dhe masave rrafshuese.

Asgjësimi (hudhja):

Mbeturinat e produktit mundësisht të mblidhen dhe të përdoren më tej. Mos lejonit të hudhen në kanalizim, ujëra apo në sipërfaqe të dheut. Komp. A: Paketimi i zbrazur mirë, i kruar gjegj. pa pikë përmbajtje është i riciklueshëm [Interseroh]. Paketimet me mbeturina të lëngshme si dhe mbeturinat e lëngshme të mblidhura janë mbeturina speciale. Paketimet me mbeturina të thara janë mbeturina të ndërtimit. Komp. B: Paketimi i letrës i zbrazur mirë, pa pikë përmbajtje është i riciklueshëm [Interseroh]. Mbeturina të produktit të mblidhen, të përzihen të dy komponentet dhe pas tharjes të hudhen si mbeturina ndërtimi.